



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:208566

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06646879

## NË EMËR TË POPULLIT

P. nr. 1613/2024

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Naime Krasniqi - Jashanica, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Adnan Kryeziu në lëndën penale kundër të pandehurit Arsim Dermishi nga Gjakovë, me numër personal ..., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prishtinë - PP II nr 581/24 F te datës 15.08.2024 të në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 16.12.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Musa Mehaj të pandehurit Arsim Dermishi, të av, Muhamet Mujaj të dëmtuarit A.D., më datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 16.12.2024 përpiloi, këtë:

### AKT GJYKIM

I akuzuari

**ARSIM DERMISHI**, nga i ati ..., nënës ..., mbiemri i vajzërisë së nënës ..., data e lindjes..., me vendbanim në rr. "...", kompleksi ... në Prishtinë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, numri i letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### ËSHTË FAJTOR

### S E P S E

**I.** Me dt.22.07.2024 dhe me dt.23.07.2024, rreth orës 04:00<sup>h</sup>, edhe më parë në vazhdimësi në shtëpinë e tyre të përbashkët në rrugën "... " në Prishtinë, I akuzuari Arsim Dermishi, me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar fizike dhe kanosje ndaj të dëmtuarit – babit të tij A.D., pas mosmarrëveshjeve që kanë pasur për masën e trajtimit të detyrueshëm në liri, I akuzuari ka filluar ta fyejë të dëmtuarin duke e shajtua dhe duke e kanosur seriozisht me fjalë "unë ty ti thyej duart dhe këmbët nëse Gjykata me qon në rehabilitim" dhe pasi që I akuzuari kthehet në shtëpi rreth orës 21:00, në ndikimin e substancave narkotike fillon të behet agresiv ndaj të dëmtuarit dhe me dt.23.07.2024 rreth orës 04:00<sup>h</sup>, e merr një thikë (brisk) nga kuzhina *mjet ky i përshtatshëm që mund të shkaktoj lëndime të rënda trupore* dhe mbyllet në dhomë të tij dhe pasi që i dëmtuari hynë në dhomën e të pandehurit, i njëjti e sulmon të dëmtuarin duke e gërvishur me thikë në dorën e djathtë, pa i shkaktuar lëndime trupore,-

- me këtë në vazhdimësi e ka kryer veprën penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

**II.** Me datë 23.07.2024, rreth orës 00:10<sup>h</sup> ne motel “...” në Prishtinë, pas kontrollit te personit dhe ne dhomën e te pandehuri nga Njësia Policor te I akuzuari Arsim Dermishi, policia kanë gjetur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 2.64 gram, të cilën marihuan I akuzuari e ka poseduar pa autorizim,-

- me këtë e ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 269 paragrafi 2 lidhur më par.3 të KPRK-së dhe neneve 364, dhe 365, të KPRK-së, të akzuarit e gjykon me:

## **DENIM ME BURRIGIM DHE DENIM ME GJOBË**

### **I. Të akzuarit ARSIM DERMISHI**

**Per kryerjen veprës penale si ne paken e pare të Aktgjykimit i shqiptohet dënim me Burgim ne kohëzgjatje 4(katër) muajve.**

**Per kryerjen e veprës penale si ne piken e dytë te Aktgjykimit i shqipton dënim me gjobe ne lartasi prej 440€ (katërqind e katër dhjet euro )**

**Ne vështrim te dispozitës ligjore te nenit 76 te KPRK së**

Të akzuarit, Arsim Dërmashit i shqiptohet **dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 4 ( katër )muaj muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet pasi i eshët llogaritur koha e qëndrimit ne Paraburgim dhe dënim me gjobë në shumën prej 440€ (katër qind e katër dhjet euro ) € e cilën gjobë, nuk do të ekzekutohet pasi i eshët llogaritur koha e qëndrimit te tij nen masën e paraburgimit**

**II.** Obligohet i akzuarit që, t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **20.00 (njëzet) Euro**, për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej **20.00 (njëzet) Euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**III.** Nga i dëmtuari A.D. kërkesës pasurore juridike nuk pati

## **A R S Y E T I M**

### **1 Rrjedha e procedurës, Historiku:**

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP/II.nr PP II nr 581/24 F te datës 15.08.2024 kundër të akuzuarit Arsim Dermishi nga Gjakovë, me numër personal 1170708560, për shkak te veprës penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me dt.24.07.2024, ka pranuar kallëzimin penal nga Stacioni Policor Qendra në Prishtinë, me nr. rastit 2024-AB-1741, të dt.24.07.2024 për shkak të dyshimit të bazuar mirë se I akuzuari Arsim Dermishi i cili me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar fizike dhe kanosje ndaj të dëmtuarit, babit të tij A.D., dhe me datë 23.07.2024, rreth orës 00:10<sup>h</sup> ne motel “...” në Prishtinë, pas kontrollit te personit dhe ne dhomën e te pandehuri nga Njësia Policor te I akuzuari Arsim Dermishi, policia kanë gjetur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 2.64 gram, të cilën marihuan I akuzuari e ka poseduar pa autorizim, me ç’e rast I akuzuari i ka kryer dy vepra penale e atë veprën penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-ës dhe veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së. Mbi këtë bazë Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimit me dt.24.07.2024 për të pandehurin Arsim Dermishi dhe pas analizimit të hollësishëm të kallëzimit penal, dhe shkresave tjera të lëndës, nga ana e Prokurorit, janë siguruar prova dhe të provuarit, se I akuzuari i lart cekur i ka kryer veprat penale që i vihet në barrë, në kohë, vend dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuze.

### **Kompetenca e gjykatës:**

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas pranimit të aktakuzës, ka bërë vlersimin e kompetencës, andaj duke u bazuar në nenin 29 paragrafi.1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në Prishtinë e që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate. Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku i akuzuari akuzohet për shkak të veprës penale , Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së “ e ,te cilat vepra penale janë ë e dënueshme deri në 3 (tri ) vjet burgim, andaj bije në kompetencë lëndore të këtij departamenti.

### **Shqyrtimi gjyqësor:**

Gjykata pas analizimit dhe vlersimit të aktakuzës, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë:22.08.2024 , ku gjatë kësaj seance kanë qenë prezent Prokurorja e Shteti Musa Mehaj i akuzuari Arsim Dermishi me mbrojtësin e tij av Muhamet Muja ka munguar i dëmtuari A.D. i cili ka njoftuar gjykatën se nuk eshët ne gjendje te mire shëndetësore andaj nuk mundet te prezanttoj , ku i akuzuari pasi që jan lexuar të drejtat e tij në harmoni me nenin 241 të Kodin e Procedurës Penale nga ana e gjykatës, ka theksuar se don qe të deklarohet.

I akuzuari Arsim Dermishi , në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar, se e pranon se është fajtor, per veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope

ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së tutje ka theksuar se Nuk ndihet fajtor per veprën penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së

Mbrojtësin e tij av Muhamet Muja ka deklaruar se paraprakisht ishte konsultuar mjaftueshëm me te mbrojturin nga ai per pasojat dhe fajësisë pranimit te fajësisë dhe ai e pranon veprën penale si ne piken e dyte et akuzës kurs e nuk e pranon veprën penale si ne piken e pare te aktakuzës

Prokurori i Shtetit Musa Mehaj , lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar, duke theksuar se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, per piken e dyte te aktakuzës andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese.

Andaj gjykata me aktvendim pranoi, pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.2 të KPRK-së.

Kurse per veprën penale Sulmi, nga neni 184 par.2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së per të cilën i akuzuari është deklaruar I Pa fajshëm gjykata ne vështrim te dispozitës ligjore te nenit 240 par 7 te KPP-se gjate shqyrtimit fillestar i akuzuari është njoftuar me e drejtën e tij se deri me datë 22.09.2024 mund të paraqesin kundërshtimet për provat e paraqitura në aktakuzë, kërkesat për hedhje të aktakuzës nëse e njëjta është e ndaluar ligjërisht apo kërkesë për hedhje të aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit Arsim Dermishi Av. Muhamet Mujaj, brenda afatit ligjor gjykatës i ka paraqitur me shkrim kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin provave, me të cilën kanë theksuar se: Kundërshtojmë Aktakuzën e Prokurorisë Themelore, për faktin se është e pa argumentuar nga ana e prokurorisë dhe e bazuar në prova të pa vërtetuara, pasi që prokuroria nuk ka arritur që të dëshmojë dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i im ta ketë kryer veprat penale sipas aktakuzës, dhe si e tillë nuk i përmban elementet esenciale te veprës penale. Andaj si e tillë aktakuza nuk është mbështetur në prova materiale dhe i ka propozuar gjykatës që ta hedh aktakuzën dhe ta pushoj procedurën ndaj të pandehurit Arsim Dermishi.

Gjykata pas pranimit të Kërkesës për hedhje të aktakuzës nga I akuzuari Arsim Dermishi, i ka dërguar një kopje për përgjigje në kërkesë Prokurorit të çështjes së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe e njëjta është përgjigjur me shkrim: konsiderojmë se pretendimet në parashtrësë nuk qëndrojnë për arsye se elementet e veprës penale vërtetohen nga provat me të cilat është mbështetur aktakuza, dhe se me veprimet e të pandehurit janë manifestuar të gjitha elementet e veprave penale si në aktakuzë. Andaj mbi këto prova i ka propozuar gjykatës qe të caktoj dhe të mbajë seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe pas administrimit të provave të vërtetohet gjendja faktike.

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës së paraqitur nga mbrojtësja e të pandehurit Arsim Dermishi Av. Muhamet Mujaj, lidhur me kundërshtimin e provave dhe hedhjen të

aktakuzës, si dhe përgjigjes së Prokurorit të Shtetit, gjeti se: Kërkesa e ushtruar nga ana e nga mbrojtësja e të pandehurit Arsim Dermishi Av. Muhamet Mujaj, për kundërshtim të provave dhe hedhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.581/24F e dt.15.08.2024, lidhur me veprat penale Sulmi, nga neni 184 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së , **është e pa bazuar**. Andaj ka mare vendim per Refuzimin e kërkesës per hedhje et aktakuzës deh kundërshtimin e provave dhe per këtë çështje do te shkohet ne shqyrtim gjyqësorë Ky vendim nuk eshët atakuar

Kjo Gjykatë e ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë me dt 13.12.2024, ku kanë qenë prezent Prokurorja e Shteti Musa Mehaj i akuzuari Arsim Dermishi me mbrojtësin e tij av Muhamet Muja dhe i dëmtuari A.D.

Gjykata e ka udhëzuar te akuzuarin ne vështrim te dispozitës ligjore te nenit 319 te KPP se dhe i akuzuari eshët deklaruar i Pa fajshëm Tutje shqyrtimi ka vazhduar ne dhënien e fjalës hyrëse ne administrimin e provave materiale dhe personale ai ne vijim Raporti fillestar i dt.23.07.2024, Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik AKF/2024-2506/24-2382 te dt.07.08.2024, Foto dokumentacioni ne shkresat e lendes, Deklaratat e të dëmtuarit A.D. e dhënë në polici me dt.23.07.2024 dhe në Prokurori me dt.30.07.2024, Deklaratat e të pandehurit Arsim Dermishi e dhënë në polici me dt.23.07.2024 dhe ne prokurori me dt.15.08.2024, Informacionet e personit per te kaluarën kriminale te tij ne dhnjen e mbrojtjes Te akuzuarit dhe ne marrjen e fjalës përfundimtare te palëve ne procedure

## **2. Pretendimet e Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i shtetit, në fjalën hyrëse ka deklaruar Prokuroria ka ngritur aktin akuzues kundër Te akuzuarit Arsim Durmishi ketë aktakuzë prokuroria e ka mbështetet me prova bindëse, ashtu qe ne këtë seancë te dëgjohet i dëmtuar, - dëshmitari A.D. i cili na ka tregu dhe do te na tregoj lidhur me këtë rast penal, po ashtu ne procedurën e nxjerrjes se provave te nxjerrtë Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik AKF/2024-2506/24-2382 te dt.07.08.2024, Foto dokumentacioni ne shkresat e lendes, rapirit i i faranikes i darës i dt 07.08.2024 Fpto dokumentacioni ne shkresat e lendes, aktgjykimi me n P.nr, 864/2021 i datës 23.04.2021 raporti i oficerit i datës 23.07.2024 te dëgjohet I akuzuari se çka ka me thënë dhe ne funde do te verbohët gjendja faktike si ne Aktakuze

Ndërsa në fjalën përfundimtare veç tjerash ka theksuar se: Me administrimin e provave dhe dëshmime gjatë shqyrtimeve gjyqësore në mënyrë të padyshimtë dhe të plotë është vërtetuar se i akuzuari Arsim Dermishi i ka kryer veprat penale si ne diapozitivit të aktakuzës Tutje ka shtuar se me rastin e analizimit te të gjitha provave të siguruar gjatë procedurës hetimore dhe këtyre provave te administruar gjatë shqyrtimi gjyqësor mbetem në tërësi pran aktakuzë PP.II.nr.581/24F, të dt. 15.08.2024 të ushtruar kundër të akuzuarit Arsim Durmish, në vështrim të veprës penale si ne aktakuze, Gjendja faktike ne këtë çështje vërtetohet në bazë të dëshmisë se te dëmtuari A.D. si dhe provave dhe atë Foto dokumentacion në shkresat e lendes, vërtetimi mbi sekuestrimit e sendeve i datës: 23.07.2024,dhe provave të tjera si ne aktakuze. Gjykate e nderuar edhe pse i dëmtuar-dëshmitar e shfrytëzoj të drejtën nga neni 124 të KPRK-së, qe mos të deklarohet mirëpo mbetet pranë deklaratës se dhëne në Prokurori, në datë 30.07.2024 dhe i cili na e ka elaboruar në mënyrë të detajuar se si ka mosmarrëveshje me djalën e ti, për shkak të përdorimi të substancave narkotike, për shkak që prindi im ka kërkuar nga i njëjti qe te shkoj të trajtohet dhe për shkak se i njëjti ka filluar qe te nxehet dhe ka fyer dhe ka kanos të dëmtuarin me fjale “unë ty ti thyej duart dhe këmbët nëse gjykata me qon ne rehabilitim” po ashtu edhe me

date 23.07.2024 pasi që i njëjti është kthyer në shtëpi nën ndikimin e substancave narkotik ka hy në kuzhinë e ka marr një thikë, brisk dhe ka shku në dhomën e tij, prindi i tij tani i dëmtuar, duke parë gjendje e tij, nga frika mos po i banë gjë prindit të tij ka hy dhe në konflikt e sipër e ka grithur në dorën e djathtë. Gjykate e nderuar, patëm rast që të pandehurin ta dëgjojmë i cili nder të tjera citoj, se babin e ka “idoll, dhe se i njëjti çdo deklaram që ka bere është e vërtet edhe e ka bere për te mite time”. Qe domethënë që i dëmtuari e ka thënë në vërteten, ndërsa i pandehuri, i ik te vërtetës duke thënë se e ka iniciuar vete konflikte. Andaj, gjykatës i propozoj që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit e duke vepruar edhe konform dispozitave të neni 70 par 2 të KPRK-së ndaj të akuzuarit Arsim Durmishi, të vlerësohet rrethanë rendues në përcaktimin e llojit dhe lartësi së dënimit si dhe dënimi të jepet me urdhëruesin e politikave ndëshkimore dhe si i till të jepet në përputhje me nenin 38 qëllimi i dënimit, përkatësisht pike 1.1 të KPRK-se, dhe se kundër të pandehuri të lartë cekur i cili këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe me qëllim të kryerje se kësaj vepër penal , pra ka qene i vetëdijshëm për veprimet e tij, ndërsa prokurori i rrethane lehtësues nuk gjeti. Propozoj, që i akuzuari Arsim Durmishi të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligji dhe në rastin e marrjes së dënimit gjykata të këtë parasysh të gjitha rrethanat tjera.

I dëmtuari A.D. deklaroj se qëndron prapa thënieve të Prokurorit të Shteti

### **3. Pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij**

Mbrojtësi i të akuzuarit Arsim Durmishi Av. Muhamet Mujaj, në fjalën hyrëse ndër të tjera ka deklaruar se: konsiderojmë se aktakuza e paraqitur kundër të mbrojturit tim është në tërësi e pabazuar se mbrojtja qëndroj prapa kërkesën për hedhje të aktakuzës, e asnjë nga provat, gjithmonë qofshin apo personal apo material nuk vërtetohet figura e veprës penale të sulmit, është e vërtet si i mbrojturi im ka qene në një gjendje depresive për shkak të rrethanave me ish bashkëshorten e tij, por në raport me të dëmtuarin nuk dëshmohet asnjë veprim i tij në drejtim babil të tij, gjate shqyrtimi gjyqësor do të vërtetohet pafajësia e të mbrojturit e po ashtu do të vërtetohet se ka qene me shume një konflikt verbal dhe mosmarrëveshje.

Ndërsa në fjalën përfundimtare veç tjerash ka theksuar se: Gjate këtij shqyrtimi gjyqësor është dëshmuar përmes provave materiale por edhe ato personal se fare nuk kemi të beje me veprën penale të sulmit, derisa pretendon në aktakuze se kemi përdorim të thikës e realisht nuk është gjete e as ndonjë ekzaminimi i lëndimit nuk mund të konsideroj se janë plotësuar kushtet e figurës së kësaj veprë penale të tillë, nëse kjo gjykatë gjene në baze të këtij shqyrtim gjyqësor ndonjë detal, ndonjë veprim, si rezultat i mosmarrëveshjes në mes të prindit dhe djalit të tij dhe kjo mosmarrëveshje e përshkruar nga i akuzuar, dhe i përshkruar nga veprimet e të dëmtuarit, nëse e njëjta hynë e konsideron gjykata që hynë në kuadër të sulmit, kërkojmë nga gjykata që të shqiptoj një dënim i cili është në raport me mosmarrëveshje e përshkruar dhe që ka mundësin e rehabilitimit të qëllimit të dënimit si rrethanë lehtësues ta marr kërkimin, faljen e vazhdueshme në raport me prindin e tim, dhe pendimin që i ka paraqitur pran kësaj gjykate, e po ashtu edhe gatishmërinë e tij që të kthehet në familje dhe të mos e përsëris asnjëherë çfarëdo veprimi të mosmarrëveshje, në e dëgjua të akuzuar në deklaramin e tij se nuk ka qene duke përdor narkotik po barna anti derësve , krejt kjo si rezultat në raport me ndarjen nga ish e dashura e tij , që është edhe një rrethanë tjetër shtesë që me rastin e shqiptimit të çfarëdo dënimi të jete në raport me rehabilitimin e tij që është edhe qëllim i dënimit. Po ashtu kërkoj nga gjykata që ta ndërpres masën e rehabilitimit duke marrë parasysh se kanë pushuar kushtet për caktonim e kësaj masën, e marrë parashush edhe deklaramin e të dëmtuarit se nuk ndjehet i dëmtuar.

I akuzuari Arsim Dërrmishi në mbrojtjen e tij te dhanë në shqyrtimin gjyqësorë ne prezencën e mbrojtësit te tina me autorizim Av. Muhamet Mujaj, i cili e ka pranuar se marihuanë e ka ble dhe se e tina është dhe se policia ja kanë gjetur ne dhomë, e mohon se e ka fye dhe e ka kanosur babanë e tij dhe se nuk ka pasur thikë, brisk ne dorë dhe nuk e ka sulmuar babanë e tij. kurse në fjalën e tij përfundimtare deklaroj mbetem ne tërësi mbrapa fjalës se te mbrojturi tim

#### **4. Provat e administruara dhe të vlerësuara**

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat në bazë të nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij, duke i mundur të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhmëni më njëra tjetrën si tërësi dhe si rezultat i vlerësimit të tyre, është provuar se tani i akuzuari Arsim dërrmishi i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike të pretenduar me aktakuzën Gjykata ka administruar provat personale përkatësisht ka dëgjuar se pari dëshmitarin A.D. ndërsa në cilësinë e provave materiale ka administruar provat si në vijim: Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik AKF/2024-2506/24-2382 te dt.07.08.2024, ne konstatimin dhe mendimin përfundimtare, ku sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmia me shifrën D-1 përmban Kanabis (Marihuanë) qe përmban Tetrahidrokanabinol (THC0 , me peshë neto: 2.64 gremë.

#### **4.1 Dëshmia e te dëmtuarit i dëgjuar si dëshmitar A.D.**

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar dëshminë e te dëmtuarit A.D. , të dhënë në shqyrtim gjyqësor, dhe krahasuar me dëshminë e tij te dhëne ne hetuesi dhe ne zyre et Prokurorit te Shtetit i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, të cilit me parë i është lexuar paralajmërimi konform dispozitës se nenit 129 par.1 të KPPRK-së. Në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka deklaruar se: në deklaratën se mbetet prapa deklaratës qe e ka dhen ene Prokurori, me dt.30.07.2024, i cili ka deklaruar jetoj me bashkëshorten time dhe tre fëmijët, jam pronar i Kopanisë Katër A Pika. Në momentin kur Arsimi nuk konsumon lende narkotike raportet tona janë të shkëlqyera, ndera në momentin kur ai abozon me substanca narkotike, ai fillon të jetë agresiv, nuk është vetë vetja dhe është i dhunshëm. Agresiv që i njëjti do të thotë fillon të më fyej, të më shaj dhe të jetë kërcënues gjatë krejt situatës, gjë që unë në shumicën e rasteve jam i detyruar të heshti ose situata mund të eskaloj me pasoja që nuk dihet se ku do të jetë përfundimi. Me datën 21.07.2024 kur ne kemi qenë në seancë tek gjyqtari Eroll Gashi, unë i kam kërkuar gjyqtarit që ta marr një vendim për kthimin e Arsimit në Forenzik, detyrim i mbyllur sepse gjendja e tij është duke u vështiruar me të madhe, sepse edhe në seanca Arsimi ka filluar të jetë agresiv, ku kërkonte nga unë në seancë që unë të nënshkruaj një dokument në prezencë të avokatit të tij që unë të pranoj ta tërheq padinë për rastin e mëhershëm, unë kam thanë se unë nuk do ta nënshkruaj këtë dokumente deri sa ti je në këtë gjendje derisa të pranosh të trajtohesh unë nuk do ta tërheq denoncimin. Kemi dal nga gjykata dhe unë kam shkuar në punë, ai gjatë asaj kohe më ka telefonuar disa herë, ndërsa unë nuk ja kam hapur telefonin asnjëherë me friken se po eskalon situata. Me datën 22.07.2024 rreth orës 18:00 Arsimi është ardh në banesë, por gjithmonë duke provuar ti acaroj raportet me mua, e kam lutur disa herë mrena një kohe të shkurt që ai të qetësohet për fjalët e tij ndaj meje, në atë moment Arsimi i nevrikosur, ka filluar të më shaj me nënë dhe duke më kanosur e duke më thënë “unë ty ti thyej duart dhe këmbët nëse gjykata më qon rehabilitim” dhe i njëjti i

nervozuar ka dal nga banesa. Ndërsa Arsimi ka ardhur në ora 21:00 në shtëpi dhe e kemi vërejt që prap ka konsumuar kokainë. Diku ka ora 04:00 e mëngjesit ka ardhur në kuzhinë dhe ka marr një thikë të vogël të pemëve dhe ka tentu me thikë të futet në dhomën e vetë, ndërsa unë nga frika duke e pa gjendjen e tij kam pasur frikë që do e dëmtoj trupin e vet me atë thikë, jam futur në dhomën e tij duke provuar të ja heq thikën nga dora, dhe gjatë asaj kacafytje, ai me të njëjtën thikë duke u kacafytur me të më ka goditur me thikë në dorën e djathtë, nuk ka qenë ndonjë lëndim i madh por një grithje, unë kam arrit të ja marr thikën nga dora dhe kam dal nga dhoma e tij. Përfundimisht ka theksuar se beson në reflektimin e tij në të ardhmen sikur që ka theksuar se gjeja kryesore është rehabilitimi i djalit të tij .

Me dëgjimin e dëshmitarit A.D. , Gjykata ka vërtetuar faktet si në vijim: Me dt.22.07.2024 dhe me dt.23.07.2024, rreth orës 04:00<sup>h</sup>, edhe më parë në vazhdimësi në shtëpinë e tyre të përbashkët në rrugën "...” në Prishtinë, I akuzuari Arsim Dermishi, me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar fizike dhe kanosje ndaj të dëmtuarit – babit të tij A.D., pas mosmarrëveshjeve që kanë pasur për masa e trajtim të detyrueshëm në liri, I akuzuari ka filluar ta fyej te dëmtuarën duke e shajtua dhe duke e kanos seriozisht me fjalë "unë ty ti thyej duart dhe këmbët nëse Gjykata me qon në rehabilitim" dhe pasi që I akuzuari kthehet në shtëpi rreth orës 21:00, nën ndikimin e substancave narkotike fillon të behet agresiv ndaj të dëmtuarit dhe me dt.23.07.2024 rreth orës 04:00<sup>h</sup>, e merr një thikë (brisk) nga kuzhina *mjet ky i përshtatshëm që mund të shkaktoj lëndime të renda trupore* dhe mbyllet në dhomë e tij dhe pasi që i dëmtuari hynë në dhomën e të pandehurit, i njëjti e sulmon te dëmtuarin duke e gërvisht me thikë në dorën e djathtë, pa i shkaktuar lëndime trupore,-

Nga provat me shkrim raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzik AKF/2024-2506/24- 2382 te dt.07.08.2024, foto dokumentacioni në shkresat e lendes, foto dokumentacioni i marihuanes me peshore në shkresat e lendes, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.23.07.2024, vërtetohet se ky i akuzuar është abuzues i substancave narkotike se një kohe ka qëndruar në IPF por se abstenimi nga këto substanca e ve në sjellje të kundërligjshme

### **Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:**

Se i akuzuari Arsim Dermishi pas mosmarrëveshjeve që kanë pasur për masa e trajtim të detyrueshëm në liri, I akuzuari ka filluar ta fyej te dëmtuarën duke e shajtua dhe duke e kanos seriozisht me fjalë "unë ty ti thyej duart dhe këmbët nëse Gjykata me qon në rehabilitim" dhe pasi që I akuzuari kthehet në shtëpi rreth orës 21:00, nën ndikimin e substancave narkotike fillon të behet agresiv ndaj të dëmtuarit dhe me dt.23.07.2024 rreth orës 04:00<sup>h</sup>, e merr një thikë (brisk) nga kuzhina *mjet ky i përshtatshëm që mund të shkaktoj lëndime të renda trupore* dhe mbyllet në dhomë e tij dhe pasi që i dëmtuari hynë në dhomën e të pandehurit, i njëjti e sulmon te dëmtuarin duke e gërvisht me thikë në dorën e majtë, pa i shkaktuar lëndime trupore, dhe

është vërtetuar mbi bazën të provuarit se ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par përmbushur elementet e veprës penale Po ashtu Me datë 23.07.2024, rreth orës 00:10<sup>h</sup> në motel "Venecia" në Prishtinë, pas kontrollit të personit dhe në dhomën e të pandehuri nga Njësia Policor të I akuzuari Arsim Dermishi, policia kanë gjetur një qese me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 2.64 gram, të cilën marihuan I akuzuari e ka poseduar pa autorizim,-me këtë e ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.



### **Shqiptimi i sanksionit penale:**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti e ka pranuar veprimet edhe pse nuk është ndier fajtor se ishte nen ndikim te substancave narkotike po ashtu pendesa e ti sepse në kohën kur kishte kryer veprën penale ishte i ri, ndërsa si rrethanë rënduese gjeti faktin se I akuzuari me dashje ka kanosur babin e tij ashtu siç përshkruhet në aktakuzën e cila i vihet në barrë, andaj gjykata duke i marrur për bazë rrethanat lehtësuese si dhe rrethanat rënduese të akuzuarit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj Gjykata, duke i pasur parasysh këto fakte të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindjen se dëmtimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të tij se do të shërbej si preventiv individuale dhe gjenerale, do ta parandaloj se në të ardhmen të mos kryej vepra penale po ashtu do të ndikoj në rehabilitimin e tij si dhe do t'i përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave të njëjta penale çka është edhe efekti i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPPK-së.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që, i akuzuari abuzon me narkotik të llojit Marihuan andaj edhe refuzonte të trajtohej në institucionet përkatëse dhe e sulmon babin e tij ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e cila i vihet në barrë

### **Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve te procedurës penale:**

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi .1citet se: *Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.*

### **Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:**

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 181 paragrafi 2 lidhur më par.3 të KPRK-së, si dhe neneve 242 par.2, 269, 276, 358 dhe 364, 365, 452, 462, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr. 1613/2024

**2024:208566, 16.12.2024 , 23.08.2024**

Numri i lëndës: 2024:208566  
Datë: 24.12.2024  
Numri i dokumentit: 06646879

**Gjyqtarja:**  
Naime Krasniqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.